



Letra nga Taizé

AL

LETRA 2011

Letra nga Kili

Kur vendosëm, së bashku me përgjegjësit e baritores rinore të Kilit, që takimi ynë i dytë ndërkombëtar në Amerikën Latine do të zhvillohej në Santiago, nga data 8 deri më 12 dhjetor 2010, nuk e imagjinonim se viti 2010 do të kishte qenë për kilenët një periudhë provash të përpjesëtuara me gëzimet. Përgatitja e këtij takimi të të rinjve ka zgjatur gjithë vitin dhe ka qenë rast i bashkëndarjes së ndërsjellë për shumë nga vëllezërit tanë.

Pikërisht në momentin në të cilin kilenët, së bashku me vende të tjera latino-amerikane, po festonin njëqindvjetorin e dytë të Republikës, dhuna e tokës dhe e detit shkaktoi vuajtje të mëdha.

Tërmeti i shkurtit goditi sidomos të varfrit. Por hovi i bujarisë që u ngjit nga thellësia e shpirtit kilen lejoi të kuptohej se sa shumë kilenët formojnë një familje të vetme, të bashkuar në kundërshtitë. Shumë të rinj kilenë shkuan të ndihmonin ata që kishin humbur shtëpinë dhe punën. Dhuruan kohën e tyre dhe energjitë e tyre për të ndërtuar disa mediasaguas, kasolle të vogla prej druri që shërbejnë si banesë e përkohshme.

Në të njëjtin vit, popullsitë autoktone të Kilit, veçanërisht disa grupe të popullit Mapuche, me një grevë të gjatë urie, shprehën vuajtjen e tyre dhe pritjet e tyre. Disa kohë më pas, imazhet e tridhjetë minatorëve që po ngjiteshin përsëri në sipërfaqe pas incidentit të minierës i rikthyen gëzimin gjithë popullsisë.

Në fillim të dhjetorit, takimi ndërkombëtar u lejoi shumë të rinjve, jo vetëm të Kilit por edhe të të gjithë kontinentit, që të bashkëndanin gëzimet, ankthet e sfidat, si edhe të vepronin për realizimin e një bote vëllazërore.

Kemi qenë shumë të kënaqur të mikprisnim në këtë takim disa të rinj të Haitit. Prania e tyre ka kujtuar dëshpërimin shumë të madh të shkaktuar në vendin e tyre prej tërmetit të janarit 2010. Plagët janë ende larg prej shërimit. Nëse situata politike e shoqërore e lejon, një vizitë në Haiti, mes takimit të Santiagos dhe atij europian të Roterdamit (fundi i dhjetorit 2010), do të lejohet të shprehet solidariteti i të rinjve të të gjitha kontinenteve si dhe admirimi i tyre: mes kundërshtive feja e mban në këmbë këtë popull.

Do të vazhdojmë të lutemi për ta gjatë vitit të ardhshëm: O Hyj shpresa jonë, po të besojmë popullin e Haitit. Të çorientuar prej vuajtjes së pakuptueshme të të pafajshëmve, po të kërkojmë ta udhëheqësh zemrën e atyre që sjellin ndihmat e domosdoshme. E njohim fenë e thellë të popullit të Haitit. Ndihmoji ata që vuajnë, forcoji ata që janë të dëshpëruar, ngushëlloji ata që qajnë, dërgoje Shpirtin tënd të dhembshurisë mbi këtë popull kaq të dërrmuar e kaq të dashur.

GËZIMI

Gëzimi i zemrës, ja jeta jote. Lëre trishtimin!¹ Kjo ftesë e një besimtari që ka jetuar para Krishtit na drejtohet edhe ne sot.

Në jetën tonë, kalojmë prova dhe vuajtje, nganjëherë për periudha të gjata. Por do të donim gjithmonë të mundohemi për ta rigjetur gëzimin e jetës.²

Nga ku vjen ai?

Ai zgjohet nga befasia e një takimi, nga qëndrueshmëria e një miqësie, nga krijimi artistik apo edhe nga bukuria e natyrës...

Dashuria që na sjell bën të lindë një lumturi, duke e mbushur pak nga pak thellësinë e shpirtit.³

E atëherë jemi të prirur të zgjedhim gëzimin. Nganjëherë ata që i njohin varfërinë dhe

1 Shih Siracidi 30,22-23. Një i krishterë i shekullit të dytë me emrin Erma shkruan edhe: «Prandaj, vishu me gëzim. Do të jetojnë në Hyjin ata që e largojnë trishtimin dhe vishen me gëzim.»

2 Ajo që e çon jetën njerëzore në një përmbushje jo vetëm të sipërmarrjeve spektakolare, por në gëzimin e kthjellët që prek thellësitë e zemrës. Karakteri i paplotë i çdo jete njerëzore, fragmentimet dhe vuajtjet nuk zhduken, megjithatë, nuk ia marrin frymën kthjelltësisë.

3 Teologu ortodoks Alexandre Schmemmann (1921-1983) ka shkruar në Gazetën e tij: «Gëzim për asgjë, megjithatë gëzim, gëzim për praninë e Hyjit dhe për një gjest të tij që prek shpirtin. Është përvoja e kësaj prekjeje, e këtij gëzimi (që efektivisht "askush nuk do të mund të na e heqë" sepse ai është bërë vetë fundi i shpirtit), kjo përvojë përcakton kursin, drejtimin e mendimeve, marrëdhënien me jetën.»

privimet janë të aftë për një gëzim jete krejtësisht të vetvetishëm, një gëzim që i bën ballë shkurajimit.⁴

Kur, në raste të ndryshme, Bibla na fton në gëzim, ajo tregon edhe burimin e tij. Ky gëzim nuk varet vetëm prej rrethanave të momentit, ajo vjen prej besimit në Hyjin: «Gëzohuni gjithmonë në Zotin, rishtas po ju them: gëzohuni... Zoti është afër».⁵

Krishti nuk ka ardhur për të themeluar një besim që do t'u bënte konkurrencë të tjerëve. Në të, Hyji ka bashkëndarë gjendjen tonë me qëllim që çdo qenie njerëzore të dijë se është e dashur nga një dashuri amshimi dhe kështu e gjen gëzimin e vet në një bashkim me Hyjin. Të besojmë në të, dhe sytë tanë hapen edhe më shumë para gjithçkaje që shtë njerëzore, dashuria e një nëne për të birin, devotshmëria e atyre që kujdesen për të sëmurët... Në këto vepra bujarie Krishti është i pranishëm, nganjëherë pa qenë i njohur.⁶

Krishti prodhon një përtëritje rrënjësore të qenies njerëzore. Këtë jetë të re, ai vetë e ka jetuar më parë dhe ka luftuar për të qëndruar besnik. Në vigjiljen e arrestimit të tij theu bukën duke thënë këto fjalë të mistershme: «Ky është trupi im që flijohet për ju».⁷ Po, ai është «Fjala që është bërë njeri».⁸ Vdekjen e tij të padrejtë e ka shndërruar në dhurim të jetës së tij. I ngjallur prej të vdekurve, hukat mbi nxënësit e tij për t'u dhënë atyre Shpirtin Shenjt, vetë jetën e Hyjit.⁹

Gëzimin e Krishtit të ngjallur, Shpirti Shenjt e ka vënë në thellësinë e qenies sonë. Ai është i pranishëm jo vetëm kur gjithçka është e lehtë. Kur gjendemi përballë një detyre kërkuese, mundimi është që ta rianimojmë gëzimin. Si edhe në provat, ai mund të jetë i fshehur sikurse prushi nën hirin, që nuk shuhet.¹⁰ Në lavd le të lejojmë

që ai të rritet në ne, dhe papritmas ai moment kthjellohet.¹¹

DHEMBSHURIA

Zgjedhja për gëzimin nuk është një ikje larg prej problemeve të jetës. Përkundrazi, ajo lejon ta shohim në fytyrë realitetin, edhe vuajtjen.

Zgjedhja për gëzimin është e pandashme prej zgjedhjes për njeriun. Ajo na mbush me një dhembshuri të pakufishme.

Të shijojmë, edhe pse pak, gëzimin e Hyjit, na bën gra e burra të bashkimit. Individualizmi si ecje lumturie është një iluzion.¹²

Të qenit dëshmitarë të bashkimit presupozon guximin për të shkuar kundër rrymës. Shpirti Shenjt do të na dhurojë përfytyrimin e nevojshëm për ta gjetur mënyrën për t'u qenë afër atyre që vuajnë, për t'i dëgjuar ata dhe për ta lënë veten të prekemi prej situatave të dëshpërimit.¹³

Rruga e lumturisë, në ndjekje të Jezusit, gjendet në dhurimin e vetvetes, ditë pas dite. Nëpërmjet jetës sonë, në një thjeshtësi të madhe, mund të pohojmë dashurinë e Hyjit.

Sikur bashkësitë tona, famullitë tona, grupet tona të të rinjve, do të bëheshin gjithnjë

4 Pas shumë vitesh, mendoj ende për ata që i kam takuar në Haiti gjatë një vizite me frërë Roger. Në atë vend të mrekullueshëm sundon një mjerim i thellë. Nuk mund t'i harroj ato nëna që shpesh në mëngjes nuk dinë nëse gjatë ditës do të kenë se çfarë t'u japin për të ngrënë fëmijëve të tyre. E megjithatë, për pjesën më të madhe të banorëve të Haitit, edhe tërmeti i rëndë i janarit 2010 nuk e ka cenuar besimin në Hyjin.

5 Filipianëve 4,4-5.

6 Shih Mateu 25,35-40.

7 Luka 22,19.

8 Gjoni 1,14.

9 Gjoni 20,22.

10 Atë Basile Gondikakis, abat i një manastiri të Malit Athos, e shpreh me një gjuhë mistike plot me poezi: «Me shembullin dhe ndihmën e Virgjërës, çdo shpirt i qetë dhe i kthjellët, i gatshëm ndaj vullnetit hyjnor, mund të bëhet Nëna e Hyjit sipas hirit: të ngjizë dhe të lindë një gëzim të vogël që e tejkalon vdekjen.»

11 Para mundimeve të tij, Jezusi u tha nxënësve të vet: «Kështu edhe ju: tani jeni të trishtuar, por unë prapë do të vij t'ju shoh e zemra juaj do të galdojë dhe askush s'do t'ju marrë gëzimin tuaj.» (Gjoni 16,22)

12 Filozofi hebre Martin Buber (1878-1965) ka shkruar: «Ti-ja më takon nëpërmjet hirit – nuk është rezultati i kërkimit tim. Por fakti që unë e quaj Ti, që unë ia drejtoj këtë fjalë themelore është arsyeja e qenies sime, ajo që më lejon të ekzistoj... Unë bëhem vetvetja nëpërmjet Ti-së; duke u bërë Unë, unë them Ti. Çdo jetë e vërtetë është takim.»

13 Alberto Hurtado (1901-1952) është një shenjt kilen, i kanonizuar nga papa Benedikti XVI në vitin 2005. Ky prift jezuit është shumë i nderuar në vendin e vet sepse ka dhuruar jetën e vet për të varfrit. Ka qenë në zanafillën e «shtëpive të Krishtit», ku mikpritën persona pa strehim, fëmijë, gra, burra në situata të vështira. Arsyeja drejtuese e jetës së tij dhe e veprimeve të tij gjendej në këtë pyetje: çfarë do të bënte Krishti në vendin tim? Në vitin 1947, shkruante në lidhje me ata që i ishin besuar: «Gjëja e parë që duhet bërë është t'i duash... T'i duash deri në atë pikë sa të mos mund t'i durosh vuajtjet e tyre... Misioni im nuk mund të kufizohet duke i ngushëlluar me fjalë të bukura e duke e lënë në mjerimin e tyre ndërsa unë ha i qetë dhe nuk më mungon asgjë. Vuajtja e tyre duhet të më lëndojë... T'i dua për t'i bërë të jetojnë. Me qëllim që jeta njerëzore të zhvillohet në ta, inteligjenca e tyre të hapet dhe të mos banojnë në cep të rrugës. Nëse ne i duam, do të dimë se çfarë të bëjmë për ta. A do të përgjigjen? Po, pjesërisht... Asgjë nuk humbet nga ajo që bëhet me dashuri.»

e më shumë vende të mirësisë së zemrës dhe të besimit! Vende ku e pranojmë njëri-tjetrin, ku mundohemi ta kuptojmë e ta përkrahim tjetrin, vende ku jemi të vëmendshëm ndaj më të dobtëve, ndaj atyre që nuk bëjnë pjesë në rrethin tonë të zakonshëm, ndaj atyre që janë më të varfër se ne.

Njëra prej shenjave të kohës sonë është zemërgjerësia me të cilën njerëz të panumërt kanë ndihmuar viktimat e katastrofave dramatike natyrore. Në çfarë mënyre kjo zemërgjerësi mund t'i animojë shoqëritë tona, duke filluar prej jetës së përditshme?¹⁴

Sado e nevojshme të jetë ndihma materiale në disa situata urgjente, ajo nuk mjafton. Ajo që ka rëndësi, është t'u japim drejtësi personave më të nevojtarë.¹⁵

Të krishterët në Amerikën Latine e kujtojnë: lufta kundër varfërisë është lufta për drejtësi. Drejtësi në marrëdhëniet ndërkom-bëtare, jo asistencë.¹⁶

Të mësojmë për ta kapërcyer frikën. E njohim të gjithë këtë reagim mbrojtjeje që qëndron në dëshirën për ta ruajtur sigurinë tonë edhe në dëm të mirëqenies së të tjerëve. Dhe kjo duket se theksohet në kohën tonë me shtimin e ndjenjës së pasigurisë. Si t'ia bëjmë për të mos rënë pre e frikës? A nuk ia dalim duke shkuar drejt të tjerëve, edhe drejt atyre që na duken si kërcënim?

Imigrimi është një tjetër shenjë e kohëve

¹⁴ Gjatë vizitës së tij në Britani të Madhe, papa Benedikti XVI ka bërë këtë thirrje: «Bota ka qenë dëshmitare e burimeve të mëdha që qeveritë janë në gjendje të mbledhin për të shpëtuar institucionet financiare që mbahen si "tepër të mëdha për të falimentuar". Me siguri që zhvillimi i tërësishëm i popujve të tokës nuk është më pak i rëndësishëm: është një sipërmarrje e denjë për vëmendjen e botës, vërtet "tepër e madhe për të falimentuar."»

¹⁵ «Ti nuk i dhuron të varfrit prej tëndes, por i kthen të tijën, sepse ti përdor i vetëm atë që u është dhënë në përdorim të gjithëve, si diçka e përbashkët. Toka është e të gjithëve, jo vetëm e të pasurve. Por janë shumë më të paktë ata që e shfrytëzojnë se sa ata që nuk e gëzojnë. Pra, ti kthen diçka që detyrohesh, nuk dhuron falas diçka të tepërt.» (Ambrozi nga Milano, shekulli IV)

¹⁶ Në dokumentin e Konferencës së Aparecida-s (maj 2007), Kisha katolike latino-amerikane shkruan: «Të punosh për të mirën e përbashkët në botë do të thotë të nxitësh një rregullim të drejtë të ekonomisë, të financave dhe të tregtisë ndërkombëtare. Është urgjente të vazhdohet që të falet borxhi i jashtëm, me qëllim që të favorizohen investimet në dobi të zhvillimit dhe të shpenzimeve shoqërore; të parashihen disa rregulla për të parandaluar e kontrolluar lëvizjet spekulative të kapitaleve, me qëllim që të nxitet një tregti e drejtë dhe një pakësim i barrierave proteksioniste të të fuqishëmve, për të siguruar çmime të leverdisshme për lëndët e para që prodhojnë vendet e varfëruara. Kështu do të vendosen disa norma të drejta për të tërhequr e rregulluar investimet dhe shërbimet.»

tona. Ai nganjëherë perceptohet si rrezik, por është një realitet faktikisht i pranishëm dhe që tashmë realizon të ardhmen.¹⁷

Një tjetër shenjë e kohës sonë është edhe shtimi i varfërisë brenda vendeve të pasura, ku shumë shpesh braktisja dhe izolimi janë shkaqet e para të pasigurisë.

Grumbullimi i tepruar i të mirave materiale e vret gëzimin. Ai të mban në zili. Lumturia gjendet gjetiu: duke zgjedhur një stil jete të matur, duke punuar jo vetëm për përfitimin por edhe për t'i dhënë kuptim jetës, duke bashkëndarë me të tjerët, secili mund të ndihmojë për të krijuar një të ardhmje paqeje. Hyji nuk dhuron një shpirt frike, por një shpirt dashurie dhe force të brendshme.¹⁸

FALJA

Ungjilli na nxit të shkojmë edhe më larg: drejtësia duhet të zgjatet deri te falja, shoqëritë njerëzore nuk mund të jetojnë pa të. Në shumë vende të botës plagët e historisë janë të thella. Atëherë le të guxojmë t'i japim fund asaj që mund të përfundojë sot. Kështu e ardhmja e paqes, e përgatitur në zemrën e Hyjit, mund të shpaloset plotësisht.

Të besosh në faljen e Hyjit nuk do të thotë ta harrosh fajin. Mesazhi i faljes nuk mund të përdoret kurrë për të përkrahur padrejtësitë. Përkundrazi, të besuarit në faljen na bën më të lirë për t'i parë fajet tona, ashtu si edhe fajet e padrejtësitë përreth nesh dhe në botë. Na takon ne të ndreqim gjithçka që është e mundur. Në këtë ecje të guximshme gjejmë një mbështetje jetësore: në bashkësinë e Kishës falja e Hyjit mund të jepet përsëri.

Çdo qenie njerëzore ka nevojë për faljen si

¹⁷ Sigurisht, imigrimi duhet të rregullohet, jo prej frikës së të huajit, por prej një shqetësimi të vërtetë për integrimin. Për imigrantët, gjetja e vendbanimit dhe e punës, mësimi i gjuhës janë gjëra parësore. Për vendet që i presin ata, dhënia e të drejtave shkon një hapi me kërkesën e arsyeshme për respektimin e detyrave. Thirrja e të krishterëve në këtë kontekst a nuk do të jetë ajo që të tregojnë nëpërmjet jetës së tyre se frika prej të huajit si i huaj nuk është e arsyetuar? Të afëruarit, të njohurit mund të jetë një hap i parë për ta kapërcyer frikën që vjen prej mosnjohjes.

¹⁸ Shih 2 Timoteu 1,7.

Etapat e ardhshme të shtegtimin të besimit në tokë

Gjatë takimit të Roterdamit do të shpallet lokaliteti i takimit të 34-t europian të të rinjve që do të zhvillohet nga 28 dhjetori 2011 deri më 1 janar 2012.

Frère Alois do të shkojë së bashku me vëllezër të tjerë dhe të rinj të të gjithë Europës në Moskë, nga data 20 deri më 25 prill 2011, për të kremtuar Javën e Madhe dhe Pashkët bashkë me Kishën ortodokse ruse.

Mesazhet e marra për takimin e Roterdamit: shih <http://www.taize.fr>

për bukën e përditshme.¹⁹ Hyji e dhuron atë çdo ditë, falas, «ai i fal të gjitha fajet e tua».²⁰ Hapja e duarve gjatë lutjes është një gjest shumë i thjeshtë që mund të shprehë dëshirën tonë për të pranuar.

Kur në lutjen Ati Ynë themi: «Na i fal fajet tona, si i falim ne...», tashmë falja e tij ka arritur te ne. Nuk janë fjalë të zbrazëta: ndodh diçka kur ne lutemi me këto fjalë të cilat na i ka mësuar vetë Jezusi. Dhe ja tek jemi të gatshëm për të falur edhe ne dhe për të mos dënuar në mënyrë përfundimtare një person tjetër kur na ka fyer.

Krishti bën dallim mes personit dhe fajit të bërë. Deri në frymën e tij të fundit mbi kryq nuk ka pranuar të dënojë askënd. Dhe fajin, pa e minimizuar atë, e ka marrë mbi vete.

Ka disa situata në të cilat nuk arrijmë të falim. Plaga është tepër e madhe. Le të kujtojmë atëherë se falja e Hyjit nuk mungon kurrë. Përsa na përket ne, nganjëherë vetëm me etapat e mëtejshme e arrijmë atë. Dëshira për të falur është një hap i parë, edhe kur kjo dëshirë mbetet e zhytur në hidhërim.

Duke falur, Hyji jo vetëm i shlyen mëkatet, por bën edhe diçka më shumë. Dhuron një jetë të re në miqësinë e tij, të frymëzuar ditë e natë prej Shpirtit Shenjt.

Ta pranosh e ta përçosh faljen e Hyjit është rruga e hapur prej Krishtit. Ne vazhdojmë në të pavarësisht prej brishtësive tona dhe plagëve tona. Krishti nuk na bën ne gra e burra që tashmë e kanë arritur pikësynimin.

Të varfrit e Ungjillit, si të krishterë, nuk kemi pretendimin të jemi më të mirë se të tjerët. Ajo që na karakterizon është thjeshtë zgjedhja për t'i përkitur Krishtit. Duke bërë këtë zgjedhje duam të jemi krejtësisht koherentë me të.²¹

Ne të gjithë mund ta bëjmë këtë zbulim: falja e marrë apo e dhënë krijon gëzimin. Vetëdija se jemi të falur është ndoshta njëri prej gëzimeve më të thella e më çliruese. Aty gjendet burimi i paqes së brendshme që Krishti do të donte të na përçonte. Kjo paqe do të na çojë larg, ajo do të shkëlqejë për të tjerët dhe për botën.²²

f. Alois

¹⁹ Suzanne de Dietrich (1891-1981), teologe protestante e cila, në fillimet e Taizé-së, e nxiti frërë Rozherin dhe vëllezërit e tij të parë që të mos ngurronin për t'u angazhuar në bashkësi për gjithë jetën, ka shkruar: «I krishteri është njeri që jeton me faljen, që e di mirë se çdo ditë i shkel urdhrat e Zotit, por edhe se çdo ditë rikthehet te Zoti, dhe e di, me një siguri të patundur, se Zoti do ta ketë fjalën e fundit në jetën e tij. Krishti është ngarkuar me të gjithë, është bërë përgjegjës për të përpara Atit; ai nuk është i vetëm në luftë, ai të cilit ia ka dhënë vetveten nuk do ta braktisë kurrë. Siguria e tij është e bazuar, jo në atë që tashmë është, por në atë që Hyji është; në besnikërinë dhe dashurinë e Hyjit të zbuluara në Jezu Krishtin. Prandaj përparimet e tij nuk e verbojnë, Humbjet e tij nuk e shkurajojnë. Ai ringrihet gjithmonë sepse nuk i përket më vetvetes, i përket një tjetri.»

²⁰ Psalmi 103,3. I gjithë ky psalm i këndon faljes së Hyjit. Dhe profeti Isaia, në një periudhë të errët të historisë, i kujton popullit se Hyji fal gjithmonë dhe thotë: «I kam humbur porsirenë fajet e tua ...» (Isaia 44,22).

²¹ «I krishteri jo vetëm i përket Jezu Krishtit, ashtu si padyshim të gjitha qeniet njerëzore i përkasin, por i përket atij në mënyrë të veçantë: vepra që Jezu Krishti kryen në botë, bëhet edhe kuptimi i veprimit të tij, lufta që Jezu Krishti lufton në errësirat kundër errësirave bëhet lufta në të cilën duhet ta angazhojë vetveten.» (Karl Barth, 1886-1968)

²² Serafini i Sarovit, murg rus i shek. XIX (1759-1833), shkruan: «Realizojë paqen e brendshme dhe mijëra vetë përreth teje do të gjejnë shëlbimin.»